

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ Çeço Fest” shpk

Sot me date 28 Prill 2023 (dymije e njezete e tre) themeluesit :

Joan Brahimi, me numer personal J30106073D, dtl. 06.01.1993, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Rr.Harillaq Liti, Lagja “18 Shtatori” , pallati 61 , shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar.

Tomi Gjiguria, , me numer personal I80730060W, dtl. 30.07.1988, lindur ne Fier dhe banues ne Gjilek , Dhermi , Himare , shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar.

Ina Lajthia me numer personal J55623057S , dtl. 23.06.1995, lindur ne Elbasan dhe banuese ne Rr. Ymer Kurti prane postes Nr.8 , Tirane , shtetase shqiptare, madhore, me zotesi juridike dhe per te vepruar.

Klaudio Imeraj, me numer personal J50212074A, dtl. 12.02.1995, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Rr.Tahir Kadare, Lagja “Kodra e Shtufit”, Gjirokaster , shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar.

Julian Skëndo, me numer personal J21129049I, dtl. 29.11.1992, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Rr.Xhorxh Soros ,Lagja “18 Shtatori” , Gjirokaster, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar


Miratojne aktin e themelimit Shoqerise “ Çeço Fest” shpk

Neni 1
HYRJE

1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ Çeço Fest” shpk, krijohet mbi bazëne iniciativës së lirë dhe kapitalit themeltar të ortakeve te Shoqerise si me siper.
2. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ Çeço Fest” shpk krijohet dhe zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me të gjithë nenet e këtij statuti dhe të ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” në fuqi të Republikës së Shqipërisë .
3. Kjo shoqëri si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar i përballon humbjet deri në kufirin evlerës së kapitalit themeltar.

Neni 2
OBJEKTI

Shoqëria do të ketë objekt të veprimtarisë së saj:
Organizim aktiviteteve kulturore he artistike; organizim eventesh festive; drejtimi de organizimi i koncerteve, sherbim ne fushen e eventeve, promovim artistesh, agjenci artistesh, agjenci udhetimi,



dhe agenci sherbimesh, import eksport sherbimesh he mallrash te te gjitha llojeve, shitje shumice dhe pakice e mallrave te te gjitha llojeve, ne funksion te objektit kryesor te shogerise. Shoqeria, me qellim investimin e kapitaleve te saj , mund te kete interesa dhe te marre pjese ne shoqeri te tjera qe kane objekte veprimtarie te cfaredo lloj natyre, te ngjashme, apo qe lidhen me aktivitetin e saj; ajo mund te jape garanci te pergjithshme, apo edhe reale.

Shoqeria mund te kryej cdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te saj.

Neni 3

EMRI, SELIA, TERRITORI

3.1 Kjo shoqëri do të quhet Shoqëria me Përgjegjisi të Kufizuar “**Çeço Fest**” shpk.

3.2 Shoqëria do të krijojë personalitetin e saj juridik nga data e rregjistrimit të saj në QKR.

3.3 Shoqëria do të ketë seline e saj ne adresen: *Lagjia 18 Shtatori, Rr. Harillaq Liti, Pallati 61, Kati i pare, Shk.1 , Apartamenti 2, Gjirokaster.*

3.4 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Neni 4

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

4.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100 000 (njqind mije) lekë, e perbere nga 5 kuota me, te zoteruara sipas perqindjes te ortakeve te barabarta me 100% :

Tomi Gjiguria 25% gjithsej 1kuot , kontributi ne para 25 000 Lek

Ina Lajthia 5% gjithsej 1 kuot , kontributi ne para 5 000 Lek

Klaudio Imeraj 25% gjithsej 1 kuot , kontributi ne para 25 000 Lek

Joan Brahimi 25% gjithsej 1 kuot , kontributi ne para 25 000 Lek

Julian Skëndo 20% gjithsej 1 kuot , kontributi ne para 20 000 Lek

4.2 Kapitali themeltar i shoqërisë mund të shtohet në varësi të rezultateve dhe nevojave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4.3 Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar me pjesë të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrimin proporcionalisht me shumën e pjesëve të tyre.

4.4 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e saj. Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga Asambleja e Ortakëve. Zvogëlimi i kapitalit prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë.

4.5 Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar nënshkruhen plotësisht dhe pastaj shpërndahen ndërmjet ortakëve sipas ndarjes së mësipërme dhe depozitohen brenda 1 viti nga fillimi I aktivitetit te shoqerise ne nje llogari te hapur ne emer te shoqerise.

4.6 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, në rrugë trashëgimie, shitjeje, kompensim kontributi te shtuar nga ortakët , sipas legjislacionit ne fuqi.

4.7 Pjesët e kapitalit themeltar mund ti transferohen të tretëve vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që zotërojnë shumicën e pjesëve dhe jo në kushte më të favorshme se ato me të cilat i janë ofruar më parë ortakëve të tjerë.

Neni 5

FONDET E SHOQËRISË

- 5.1 Shoqëria përcakton fondet e mëposhtme :
Fondin themelor (qarkullues)
Fondin rezerve. Fonde të tjera të cilat mund të jenë të nevojshme gjatë veprimtarisë së saj.
- 5.2 Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme
- 5.3 Masa e secilit fond dhe mënyra e përdorimit të secilit prej fondeve përcaktohet me vendim të ortakeve të shoqërisë.

Neni 6

ORGANET VENDIMARRESE, MARRJA E VENDIMEVE DHE KONTROLLI I SHOQËRISË, ADMINISTRIMI

- 6.1 Ortakët e shoqërisë përballojnë humbjet e saj deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.
- 6.2 Organi Vendimarrës është Mbledhja e Asamblese së Ortakeve.
- 6.3 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë vet ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij dhe disponon një numër votash të barabart me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron.
- 6.4 Mbledhja e Asamblesë mund të thirret nga një ose disa ortakë që zotërojnë mbi 1/5 e pjesëve të kapitalit themeltar, nga Administratoret, nga ekspertët kontabël të autorizuar, po qe se ka të tillë ose nga likujduesi.
- 6.5 Asambleja e zakonshme vendos për çështje të tilla si; emërimin ose shkarkimin e administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likujduesve, miratimin e raporteve të administrimit dhe kontrollit, miratimin e llogarive vjetore dhe ndarjen e fitimit etj .
- 6.6 Asambleja e jashtzakonshme vendos për çështje të tilla si; ndryshime të Statutit, zvogëlimi i kapitalit themeltar, transferimin e kapitalit themeltar tek të tretët, zgjatjen e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likujdimin e saj, shndërrimin e shoqërisë nga SH.P.K. në një formë tjetër të shoqërive tregtare.
- 6.7 Asambleja e ortakeve vendimet e veta do të marre me shumicë votash 50+1, me përjashtim kur në ligj, kërkohej një përqindje më e lartë.
- 6.8 Shoqëria do të drejtohet nga administratori i shoqërisë “*Çeço Fest*” sh.p.k, **Z. Joan Brahimi** për një afat 1 vjeçar, me të drejtë ripërteritje specifiku të datës 28-04-2023 deri më 28-04-2024
- 6.9 Me pelqimin paraprak të Asamblese së Ortakeve, Administratori ka këto detyra:
- a. Te kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e ortakeve;
- b. Përfaqësojë shoqërinë tregtare;

- c. Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d. Përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e. Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f. Kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g. Raportoje përpara asamblesë së përgjithshme të ortakeve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

6.9.1 Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakeve edhe në rastet kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim, dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon nga një ortak të blejë pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

6.9.2 Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.

6.9.3 Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

6.9.4 Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

6.9.5 Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

6.9.6 Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 7

KOMPETENCAT E ORTAKEVE TE SHOQERISE

- 7.1 Vendosin për ndryshimet në Statut dhe miratojnë rregulloren e shoqërisë.
- 7.2 Vendosin për politikën afariste të shoqërisë dhe përcaktojnë fushat konkrete të veprimtarisë së shoqërisë.
- 7.3 Shqyrtonjne bilancin vjetor, fondet e ndryshme si dhe fitimin e realizuar.
- 7.4 Vendosin për krijimin e degëve e agjensive të shoqërisë brenda dhe jashtë vendit.
- 7.5 Vendosin për marrjen e kredive si dhe për mbarimin e shoqërisë.
- 7.6 Vendosin për shëndrrimin e shoqërisë nga sh.p.k. në shoqëri të llojeve të tjera.
- 7.7 Miratojnë ose realizojnë marrëdhëniet e shoqërisë me persona të tjerë fizikë dhe juridikë.
- 7.8 Vendosin për pagat e punonjësve të punësuar në këtë shoqëri.
- 7.9 Emërojnë një ose disa ekspertë kontabël për të ushtruar kontroll mbi aktivitetin ekonomik - financiar të shoqërisë dhe administratuarin e shoqërisë.

Neni 8

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

- 8.1 Çdo vit financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.
- 8.2 Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga Administratori dhe ose eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga Asambleja.
- 8.3 Miratimi i bilancit vjetor bëhet brenda 31 marsit të vitit pasardhës.
- 8.4 Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Asambleja përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividendeve mbi fitimin. Fitimi, që do të ndahet ndërmjet ortakëve në përpjestim me pjesët e kapitalit, përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për fondin rezervë të domosdoshëm (10% e fitimit të çdo viti deri sa ky fond të arrijë vlerën e 10 fishit të kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër të jenë zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga viti i mëparshëm.

Neni 9

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

- 9.1 Kjo shoqëri krijohet për një afat të pakufizuar dhe mund të ndryshohet në vazhdim me vendim Asambleje.

Neni 10

MBARIMI I SHOQËRISË, LIKUJDIMI


- 10.1 Veprimtaria e shoqërisë mbaron ose mund të shpërbëhet në cdo kohë sipas vendimeve që do të marrin ortakët e Shoqërisë, vetëm në rast se veprimtaria e tyre nuk rezulton fitimprurëse, për shkak të forcave madhore si dhe për shkaqe të tjera ligjore
- 10.2 Shoqëria mund të mbarojë me anë të thithjes së saj apo bashkimit.
- 10.3 Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Asambleja emëron një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjëndjen e aktivitetit dhe pasivitetit të saj, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.
- 10.4 Në fund të procesit të likuidimit Asambleja vendos mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likujduesit dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit. Mbas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuesit përkates, likujduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët e tyre në kapitalin themeltar.

Neni 11

MARRDHËNIET E PUNËSIMIT

- 11.1 Çdo person i punësuar në shoqëri konsiderohet si i punësuar mbi bazën e kontratës së punës të lidhur ndërmjet tij dhe Shoqërisë me Përgjiesi të Kufizuar "Çeço Fest" shpk në përputhje me legjislacionin e punës në Shqipëri.
- 11.2 Çdo person i punësuar në shoqëri është personalisht përgjegjës për kryerjen e detyrës.
- 11.3 Shoqëria merr përsipër t'i sigurojë çdo të punësuarit respektimin e ligjeve e rregullave të punësimit e të sigurimeve shoqërore.
- 11.4 Punonjësit e emëruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit nëse në kontratën e punës nuk parashikohet ndryshe.
- 11.5 Të gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës në shoqëri. Kjo detyrë vazhdon edhe pas largimit të tyre nga kjo shoqëri.

Neni 12




DISPOZITA TË FUNDIT


- 12.1 Pasuria e shoqërisë mund të sigurohet në cdo Insitut te Sigurimeve të Republikës së Shqipërisë.
12.2 Shoqëria do të ketë vulën e saj.
12.3 Të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit,do të zgjidhen me mirëkuptim dhe kur mirëkuptimi nuk arrihet organi kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.
12.4 Ky Statut është hartuar më, 28Prill 2023 , në pese kopje origjinale duke patur fuqi të barabarte ligjore.

Ortaket e Shoqerise
“Çeço Fest” SH.P.K.
Joan Brahim
Tomi Gjiguria
Ina Lajthia
Klaudio Imeraj
Julian Skëndo

Joan Brahim

INA LAJTHIA


Klaudio Imeraj


Tomi Gjiguria

Julian Skëndo
